PROGRAMI I TRANSPARENCËS
BASHKIA DEVOLL

Të Drejtat, Përgjegjësitë dhe Misioni i Bashkisë Devoll
Të Drejtat dhe përgjegjësitë.
Bashkia Devoll ka këto të drejta dhe përgjegjësi:
1-Të drejtat dhe përgjegjësitë e Bashkisë Devoll janë si më poshtë:

të përcaktojë masa që i gjykon të nevojshme për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave;
bazuar në Kushtetutë, në ligje dhe aktet nënligjore, nxjerr në bazë dhe për zbatim të tyre, për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave, nxjerr urdhëresa, vendime dhe urdhra;
krijon struktura administrative për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të tyre, sipas ligjeve në fuqi;
krijon njësi ekonomike dhe institucione në varësi të tyre.
krijojë komitete, borde ose komisione për kryerjen e funksioneve të veçanta sa herë që paraqitet nevoja, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore.
2-Të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë:

Bashkia Devoll ushtron të drejtën e pronësisë. Ajo fiton, shet dhe jep në përdorim pronën e paluajtshme ose të luajtshme të saj, si dhe ushtron të drejta të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
ka të drejtën e fitimit të pronës, nëpërmjet shpronësimeve për interes publik, duke ndjekur mënyrën e përcaktuar me ligj;
ka të drejtën e pronësisë e cila ushtrohet nga këshilli bashkiak, i cili nuk mund t'ia delegojë ushtrimin e kësaj të drejte askujt tjetër.
3-Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës:

krijon, mbledh të ardhura dhe bën shpenzime për përmbushjen e funksioneve të saj;
vendos taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
harton, miraton dhe zbaton buxhetin e saj;
mban llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofron informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.
4-Të drejtën dhe përgjegjësinë e kryerjes së veprimtarive ekonomike, sipas së cilës:

për përmbushjen e funksioneve publike në interes të komunitetit që përfaqëson, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ushtron veprimtari ekonomike që nuk bie ndesh me orientimet themelore të politikave ekonomike të shtetit;
të ardhurat, që përfitohen nga veprimtaria ekonomike, përdoren në pjesën më të madhe për mbështetjen dhe përmbushjen e funksioneve publike;
veprimtaria ekonomike e Bashkisë Devoll rregullohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5-Të drejtën e bashkëpunimit, sipas së cilës:

Përditësuar në datë 16.03.2026

për kryerjen e shërbimeve specifike në emër dhe në dobi të komuniteteve përkatëse, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore mund të ushtrojnë së bashku çdo funksion që u është dhënë atyre me ligj, nëpërmjet zbatimit të marrëveshjeve ose kontratave të përbashkëta, delegimit të kompetencave dhe përgjegjësive të veçanta njëra-tjetrës ose kontraktimit me një palë të tretë;
bashkëpunon me njësi të vetëqeverisjes vendore të vendeve të tjera dhe përfaqësohet në organizata ndërkombëtare të pushteteve vendore, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi;
ka të drejtën të organizohet në shoqata, në përputhje me legjislacionin përkatës.
6-Të drejtën e personit juridik:

Si persona juridikë, Bashkia Devoll gëzon dhe ushtron të gjitha të drejtat e përcaktuara në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe në legjislacionin në fuqi dhe në mënyrë të veçantë:
të drejtën e lidhjes së kontratës;
të drejtën e krijimit të personave të tjerë juridikë;
të drejtën e ngritjes së padisë civile;
të drejtën e mbajtjes së llogarive;
të drejta të tjera për ushtrimin e funksioneve në bazë dhe në zbatim të ligjeve dhe akteve nënligjore.
7-Të drejta të tjera, sipas të cilave:

jep tituj nderi dhe stimuj;
vendos emërtimet e territoreve, objekteve dhe institucioneve nën juridiksionin e saj, sipas kritereve të përcaktuara me ligj;
Bashkia Devoll ka vulën dhe simbolet e saj.

Misioni i Bashkisë Devoll.

Misioni i Bashkisë Devoll është që të sigurojë qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve të saj nëpërmjet:

njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive;
respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;
zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;
ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;
realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;
nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithë përfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;
realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.